



PROGRAMET E INDEP



Qeverisje Demokratike



Zhvillim i Qëndrueshëm



Bashkëpunim Rajonal

46  
PROJEKTE

183  
PUBLIKIME

107  
KONFERENCA  
PUNËTORI  
TRYEZA

15  
FUSHATA



40  
HULUMTIME

64  
ANALIZA

84  
REAGIME

26  
DONATORË



# 2021

# Raport Vjetor

[www.indep.info](http://www.indep.info)



# Parafjalë

## Parafjalë

Për ne

Viti 2021

Qeverisja Demokratike

Zhvillimi i Qëndrueshëm

Bashkëpunimi Rajonal

LISTA E PUBLIKIMEVE

LISTA E REAGIMEVE

Jam tejet i lumtur që 2021 shënon vitin e 10-të të punës së Institutit për Politika Zhvillimore (INDEP). Përmes hulumtimit, punës avokuese, fushatave vetëdijësuese e shumë e shumë aktiviteteve të tjera, INDEP u shndërrua në një nga organizatat më me ndikim te ne.



Gjatë një dekade pune, INDEP ka zbatuar suksesshëm rreth 50 projekte të mbështetura nga 30 donatorë të ndryshëm, e kemi lansuar 6 platforma (Investometri, Ambientalisti, Miqtë e Energjisë, Mbrojtësit e Konsumatorëve, Barometri i Rimëkëmbjes & Barometri i Ringjalljes). Kemi publikuar rreth 200 publikime, prej tyre 64 analiza dhe 40 hulumtime politikash. Me mbi 80 reagime dhe 107 tryeza dhe konferenca, ne u bëmë pikënisje e shumë debateve publike, zëri i interesit publik dhe promotori kryesor i zhvillimit të qëndrueshëm në Kosovë. Gjithashtu, jemi pjesë themeluese dhe partner në mbi 10 rrjetëzime rajonale dhe ndërkombëtare dhe nga trangu ynë ka dalë edhe organizata NewPerspektiva, e cila funksionon e pavarur tash e 5 vite.

Puna e INDEP në dekadën e dytë do të intensifikohet edhe më. Duke qenë krenar, dhjetë vjetori i parë i INDEP e gjen Kosovën me Fondin e Eficiencës së Energjisë, me qindra megavat të instaluar të energjisë së ripërtrishme dhe me një vetëdije të përgjithshme krejt tjetër nga ajo e vitit 2011. Kosova ka nënshkruar Deklaratën e Samitit të Sofjes dhe ka marrë përkushtimin për dekarbonizim të plotë deri në vitin 2050. Roli i INDEP në përshejtimin e këtij tranzicioni do të jetë konstruktiv, monitorues dhe mbështetës.

Ju faleminderit të gjithëve për mbështetjen e deritanishme. Të gjithë donatorëve, partnerëve, aktivistëve, bashkëpunëtorëve vendor dhe ndërkombëtarë si dhe spektrit të vendimmarrjes që na dhanë hapësirë për kontribut.

Ju ftoj ta shfletoni raportin vjetor të punës sonë gjatë vitit 2021.

Sinqerisht,

Burim EJUPI, Drejtor Ekzekutiv i INDEP

# Për ne

Instituti për Politika Zhvillimore (INDEP), themeluar në vitin 2011 si një shoqatë e analistëve të politikave, hulumtuesve dhe aktivistëve të shoqërisë civile, është institut kërkimor dhe qendër e avokimit që ofron zgjidhje strategjike për politika publike.

INDEP, si think-tank, këtë e arrin duke u bazuar në hulumtime të pavarura me synim krijimin e një shteti demokratik i bazuar në parimet e zhvillimit të qëndrueshëm. Andaj, puna e INDEP fokusohet në politikat zhvillimore, duke ofruar një vizion përmbajtësor për integrimet Euro-Atlantike. Në Kosovë, ku edhe vepron, INDEP ka në fokus të veçantë forcimin e qeverisjes demokratike dhe luan rolin e mbikëqyrësit të politikave publike.

Puna e INDEP mbështetet në tri programe kryesore: Qeverisja Demokratike, Zhvillim i Qëndrueshëm dhe Bashkëpunim Rajonal.



Në programin e Qeverisjes Demokratike hulumtimi i politikave kombinohet me avokim të vendosur duke u fokusuar në parti politike funksionale, sigurimin e zgjedhjeve të pavarura e të drejta, fuqizimin sundimin të ligjit dhe përparimin e lirisë së mediave.



Zhvillimi i Qëndrueshëm e bën INDEP institutin e parë në rajon që promovon zhvillim ekonomik i cili avancoon kushtet shoqërore dhe politike duke mbrojtur ambientin. Ky program fokusohet në projektet ekonomike dhe energjetike në Kosovë e rajon.



Bashkëpunimi Rajonal është parakusht për rrugën e vendeve të Ballkanit perëndimor për në Bashkimin European. INDEP synon që të promovojë dhe forcojë këtë bashkëpunim në fushat e sigurisë dhe integrimi Euro Atlantike.

Parafjalë

Për ne

Viti 2021

Qeverisja Demokratike

Zhvillimi i Qëndrueshëm

Bashkëpunimi Rajonal

LISTA E PUBLIKIMEVE

LISTA E REAGIMEVE





# INDEP gjatë vitit 2021

<b>Publikime / Hulumtime</b>	<b>15</b>
<b>Raporte</b>	<b>3</b>
<b>Buletine</b>	<b>13</b>
<b>Podcast</b>	<b>2</b>
<b>OP-ED</b>	<b>3</b>
<b>Reagime</b>	<b>7</b>
<b>Konsultime Publike</b>	<b>7</b>
<b>Infografika</b>	<b>157</b>
<b>Video</b>	<b>7</b>
<b>Evente</b>	<b>15</b>
<b>Fushata</b>	<b>2</b>
<b>Platforma</b>	<b>2</b>

# Qeverisja Demokratike

Parafjalë

Për ne

Qeverisja Demokratike

Zhvillimi i Qëndrueshëm

Bashkëpunimi Rajonal

LISTA E PUBLIKIMEVE

LISTA E REAGIMEVE

Qeverisja demokratike përbën fushën kryesore të punës së INDEP. Kontributin tonë e kanalizojmë përmes pjesëmarrjes në konsultimet publike, reagime, analiza të projektligjeve e propozimeve ligjore.

## Konsultimet Publike

INDEP-i gjatë vitit 2021 ka dërguar komente në 7 Konsultime Publike. Konsultimet Publike janë pjesë shumë e rëndësishme e punës sonë. Mes tyre, si më të rëndësishmet, ka komentuar në:

- Agjendën Evropiane të Reformave 2,
- Draft Koncept Dokumenti për plotësim ndryshimin e Ligjit për mbrojtjen e konsumatorit O6/l-34,
- Draft Ligj për vlerësimin e ndikimit në mjedis,
- Projektligjin për ndryshim dhe plotësim të Ligjit Nr.04/l-060 Për Mbeturina,
- Koncept Dokument për menaxhimin e performancës komunale dhe skemës së grantit të bazuar në performancë,
- Udhëzimin Administrativ (ME) Nr. XX/2021 për kornizën e përgjithshme të raportimit për efikasitet të energjisë.

Në këto konsultime publike, INDEP-i ka analizuar dokumentet përkatëse dhe ka ofruar komente që kanë dalë nga gjetjet e hulumtimeve të INDEP. Gjithsej, INDEP ka dërguar 45 komente, ku nga këto 15 janë të pranuar plotësisht, ndërsa 10 të pranuar pjesërisht. Nga to, veçanërisht të vlefshme INDEP i konsideron komentet e dërguara në Draft Koncept Dokumentin për plotësim ndryshimin e Ligjit për mbrojtjen e konsumatorit O6/l-34, si dhe Draft Ligjin për vlerësimin e ndikimit në mjedis, të cilat INDEP do t'i përcjellë deri në fazën përfundimtare të procesit amandamentues.



# Mbrojtja e Konsumatorit

Gjatë vitit 2021, INDEP ka punuar intensivisht në fushën e mbrojtjes së konsumatorit. Ky vit shënon vitin më të suksesshëm në punën për mbrojtjen e konsumatorit përmes platformës 'Mbrojtësit e Konsumatorëve'. Platforma virtuale në rrjete sociale ka arritur të shndërrohet në një nga platformat më të mëdha të shoqërisë civile dhe jo vetëm në vend. Materialet e kësaj platforme përfshijnë më shumë se 100 grafika informuese, 25 reagime për fushën e mbrojtjes së konsumatorit, 3 OP-EDs si dhe 3 video informuese për konsumatorët. Komuniteti virtual ka mbërritur në më shumë se 35,000 qytetarë aktivë. Ky komunitet është shndërruar në pikë kyçe të komunikimit ka dërguar më shumë se 2,500 mesazhe direkte për ekipin e 'Mbrojtësve të Konsumatorit' duke kërkuar udhëzime se ku duhet të dorëzojnë ankesa zyrtare për shkeljet që u bëhen atyre si konsumatorë.



Kemi vërejtur se me punën tonë, trajtimi i rasteve të ankesave është përmirësuar dukshëm. Duke kombinuar punën e avokimit përmes hulumtimit të politikave publike dhe aktivizmit qytetar përmes mediave sociale, ia kemi dalë të bëhemi njëkohësisht mbështetës dhe mbikëqyrës i institucioneve që merren me të drejtat e konsumatorëve. Departamenti i Mbrojtjes së Konsumatorit ka raportuar një rritje pozitive të zgjidhjes së rasteve, ndërkohë që Zyra e Rregullatorit për Energji ka raportuar se 77.73% e ankesave janë zgjidhur në favor të konsumatorëve. Kjo përqindje premtuese është tregues i mirë se ankesat janë duke pasur një efekt dhe që konsumatorët po ushtrojnë të drejtat e tyre. Mbi 300 ankesa në fushën e energjisë janë proceduar vetëm nga platforma jonë!

Rëndësia e mbrojtjes së konsumatorit u rrit veçanërisht gjatë këtij vitit të pandemisë, 2021. Konsumatorët janë përballur me rritje të organizuar të çmimeve, shkelje të të drejtave gjatë blerjeve online, moskthim e produkteve dhe praktikave të përgjithshme të padrejta tregtare. INDEP ishte veçanërisht aktiv në ngritjen ndërgjegjësimi i konsumatorit për të verifikuar shitësit përpara blerjeve dhe për të paraqitur ankesa. Kemi qëndruar në komunikim të vazhdueshëm me inspektoratin dhe jemi të kënaqur që numri i inspektimeve është rritur dhe komunikimi me konsumatorë është përmirësuar. Megjithatë, siç thekson me të drejtë Raporti i Komisionit Evropian për Kosovën, duhet të punohet shumë në mënyrë që inspektorati të jetë efektiv.

Marrëveshja kornizë e partneritetit me Zyrën e Bashkimit Evropian në Kosovë është një instrument i shkëlqyer që na ka lejuar të zhvillojmë mbrojtjen e konsumatorit si një program të brendshëm të organizatës. Puna e bërë ë vitin 2021 synohet të rritet, zgjerohet dhe të ndërtojmë një komunitet prej qindra mijëra konsumatorë vigjilentë, të pajisur me informacion dhe të mbështetur për realizimin e të drejtave të tyre. Vetëm kështu mund të përfitojmë të gjithë nga konsumatorë me të drejta të realizuara dhe një shoqëri me një zhvillim ekonomik të fortë dhe të drejtë.

# 'Mbrojtësit e Konsumatorëve'

Funded by the European Union

Rockefeller Brothers Fund

Funded by the European Union

Rockefeller Brothers Fund

Funded by the European Union

Rockefeller Brothers Fund

400€ - 2,000€  
**GJOBË!**

NËSE ÇMIMI NË RAFT NUK ËSHTË I NJËJTË ME ÇMIMIN NË ARKË!

1.29

1.29  
0.79

S'MUNDESH M'U ANKU  
PA KUPON FISKAL

"BLEJ KU T'DON" SH.P.K

Por gjithmonë  
merr kupon fiskal!

Raporto rastet e mungesës  
së kuponit fiskal në:

038 222 165



NUK JE I OBLIGUM  
ME PAGU  
PA E PA  
PRODUKTIN



MBROJTËSIT E KONSUMATORËVE  
KOSOVO CONSUMER WATCHDOG



MBROJTËSIT E KONSUMATORËVE  
KOSOVO CONSUMER WATCHDOG



MBROJTËSIT E KONSUMATORËVE  
KOSOVO CONSUMER WATCHDOG



## Dita Botërore për të Drejtat e Konsumatorëve (15 Mars)






# Rimëkëmbja & Ringjallja Ekonomike

Në gjysmën e parë të vitit 2021, INDEP ka implementuar projektin "Barometri i Rimëkëmbjes – Për transparencë dhe llogaridhënjë", financuar nga Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur (KFOS) – Kosovo Foundation for Open Society (KFOS). Ky projekt ka pasur si synim rritjen e nivelit të zbatimit të masave të parapara me Ligjin për Rimëkëmbje Ekonomike, rritjes së llogaridhënies së institucioneve, si dhe rritjes së transparencës dhe informimit të publikut ashtu që të shtohet presioni nga poshtë – lart për implementimin e plotë të Ligjit të Rimëkëmbjes. Poashtu, ky projekt ka kontribuar në rritjen e impaktit të Pakos së Rimëkëmbjes në rivitalizimin e ekonomisë dhe rritjes së mirëqenies sociale, përmes rritjes së informimit të qytetarëve, rritjes së qytetarisë aktive dhe gjithëpërfshirjes në procesin e zbatimit të saj.

Pastaj, në gjysmën e dytë të vitit 2021, INDEP ka implementuar projektin "Rimëkëmbje për Qëndrueshmëri", përmes të cilit ka promovuar Agjendën e Gjellbër, përfshirjen e qytetarëve të vendit tonë në diskutime publike dhe rritjen e transparencës në pakot stimuluese ndaj pandemisë COVID-19. INDEP ka monitoruar Pakon e Ringjalljes Ekonomike, ka informuar qytetarët e Republikës së Kosovës në detaje rreth masave të pakos dhe ka synuar të ofrojë kushte të gjithëpërfshirjes në procesin e diskutimit publik rreth pakos aktuale dhe atyre që do të pasojnë në të ardhmen. Projekti ka shpalosur të dhëna dhe informata të detajuara, përmes terminologjisë sa më të thjeshtë, në mënyrë që qytetarët të kuptojnë më mirë përfitimet e tyre nga kjo pako.

Gjatë projektit, INDEP ka lansuar materiale me informacione të detajuara sa i përket Pakos së Ringjalljes Ekonomike dhe politikave të gjelbra që duhet të jenë pjesë e kësaj pako dhe pakove pasuese stimuluese. Kështu, INDEP ka publikuar gjashtë buletine, dymbëdhjetë infografika, dy punime hulumtuese, një raport monitorues dhe një video animuese. Gjithashtu, duke synuar gjithëpërfshirjen, analizimin e situatës pandemike dhe rimëkëmbjen ekonomike, INDEP ka organizuar tre podcaste dhe dy diskutime one-on-one, ku së bashku me njohësit e fushës ekonomike, udhëheqësit e shoqërisë civile dhe përfaqësuesit e institucioneve të Republikës së Kosovës ka trajtuar problematikat aktuale dhe rrugën që vendi ynë po ndjek për të tejkaluar vështirësitë ekonomike dhe sociale që ka shkaktuar pandemia COVID-19.



# Zhvillimi i Qëndrueshëm

Parafjalë

Për ne

Qeverisja Demokratike

Zhvillimi i Qëndrueshëm

Bashkëpunimi Rajonal

LISTA E PUBLIKIMEVE

LISTA E REAGIMEVE

INDEP konsideron që zhvillimi i qëndrueshëm është një nga bazat themelore mbi të cilin duhet të ndërtohet e ardhmja e vendit. Fokusi i punës së INDEP në këtë program është puna hulumtuese në fushën e energjisë, promovimi i energjisë së ripërtëritshme, avancimi i efikasitetit të energjisë, vetëdijësimi për rolin e Objektivëve të Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZhQ-ve).

Programi i Zhvillimit të Qëndrueshëm brenda INDEP-it përfshin shtytjen para të zhvillimit ekonomik duke i respektuar parimet e mbrojtjes së mjedisit dhe duke i mbrojtur vlerat themelore shoqërore për jetë të dinjitetshme. Në këtë kontekst, energjia është sektori kryesor i këtij programi. INDEP vlerëson se viti 2021 e ka vënë Kosovën në një udhëkryq energjetik. Me anulimin e kontratës për ndërtimin e termocentralit 'Kosova e Re', Kosova ka fitur mundësi që sektori të drejtohet në projekte eco-friendly dhe të cilat garantojnë një të ardhme më të gjelbër për vendin.

INDEP përmes këtij program punon në avancimin së gjelbër energjetike, qoftë përmes publikimit të hulumtimeve të pavarura me shifra dhe rekomandime konkrete se si të arrihet kjo, avokimit të klasa politike dhe vendimmarrësë dhe qoftë përmes fushatave vetëdijësuese që targetojnë qytetarët e thjeshtë, bizneset dhe sektorin privat. Investimet në efikasitet të energjisë dhe energji nga burimet e ripërtëritshme në anën tjetër, arrihet siguria energjetike për qytetarët, duke ruajtur shëndetin dhe mjedisin tonë, por edhe avancohet pozita e Kosovës në rrugën e integritit.

Në mesin e aktivitete më të suksesshme të këtij programi për 2022 rendisim Javën e Zhvillimit të Qëndrueshëm, publikimin e 7 Hulumtimeve në fushën e energjisë dhe 4 Hulumtimeve në fushën e Objektivëve të Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZhQ-ve), punën vetëdijësuese për avancimin e agjendës për zhvillim të qëndrueshëm me komunitetin e gjerë përmes fushatave, takimet e punës me politikëbërës e politikanë, si dhe aktivitetet për promovimin e zhvillimit të qëndrueshëm që INDEP ka mbajtur.





# Java e Zhvillimit të Qëndrueshëm në Kosovë (KSDW)

Që nga viti 2018, Java e Zhvillimit të Qëndrueshëm të Kosovës (KSDW) mbetet ngjarja më e madhe për zhvillimin e qëndrueshëm në rajon, e cila mbledh në aktivitetet e saj një numër të madh të qytetarëve. Kjo ngjarje ndër vite organizohet nga Ministria e Ekonomisë, Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë, GIZ, Instituti për Politika Zhvillimore (INDEP) dhe Balkan Green Foundation (BGF), ndërsa INDEP ka qenë koordinator i edicionit të katërt të KSDW-së. Ngjarja mbledhi më shumë se 80 folës nga 6 vendet e Ballkanit Perëndimor, të cilët diskutuan mes tyre dhe audiencës në lidhje me 5 komponentet kryesore të Agjendës së Gjelbër për Ballkanin Perëndimor dhe hapat e mundshëm si të avancohet kjo agjendë në këtë rajon. 5 komponentet e kësaj marrëveshje janë (1) Dekarbonizimi, (2) Ekonomia Qarkore, (3) Largimi i ndotjes nga ajri, uji dhe toka, (4) Sistemet e qëndrueshme ushqimore dhe zonat rurale, dhe (5) Biodiversiteti. Ngjashëm me edicionet e mëparshme, KSDW 2021 kishte për qëllim të avancohte më tej kornizën e zhvillimit të qëndrueshëm në Kosovë, si dhe ta inkurajonte atë në përpjekjet e komunitetit rajonal.



KSDW 2021 u mbajt nga 31 maj deri më 11 qershor 2021. Gjatë këtyre 2 javëve, u mbajtën 3 ditë intensive të konferencës me gjithsej 5 panele diskutuese dhe 20 ngjarje paralele. Ngjarjet u ndanë në (1) ngjarje kryesore dhe (2) ngjarje paralele.

• Përgjatë 3 ditëve, KSDW organizoi panele diskutuese mbi temat

(Dita 1 e Konferencës) Dekarbonizimi: Klima, energjia dhe mobiliteti

(Dita 2 e Konferencës) Ekonomia Qarkore: Prodhimi dhe konsumi i qëndrueshëm & Largimi i ndotjes nga ajri, uji dhe toka

(Dita 3 e Konferencës) Sisteme të qëndrueshme ushqimore dhe zona rurale & Mbrojtja e biodiversitetit: Mbrojtja dhe restaurimi i ekosistemeve



KSDW 2021 filloi më 31 maj në Shkollën e Gjelbër në Prishtinë. Ngjarja lansuese u mbajt qëllimisht në ambientet e Shkollës së Gjelbër. Ngjarja mbledhi në një vend të vetëm përfaqësues të nivelit të lartë të shtetit dhe Qeverisë, si Presidentin, Kryeministrin, Ministrin e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, Ministren e Ekonomisë, përveç përfaqësuesve nga misionet diplomatike dhe komuniteti i donatorëve, përkatësisht EUSR, Ambasada Gjermane, dhe GIZ Kosova.



# Dita Botërore e Mjedisit (5 Qershor)

Këtë vit, INDEP shënoi Ditën Botërore të Mjedisit në kuadër të KSDW-së, së bashku me EUSR, BGF dhe Komunën e Prishtinës kanë organizuar në kuadër të KSDW-së ngjarje ndërgjegjëse gjatë gjithë ditës. Aktiviteti i parë u zhvillua në qendrën e qytetit të Prishtinës, konkretisht në Sheshin Zahir Pajaziti, ku kishte shumë lojëra të krijuara për të rritur ndërgjegjësimin e fëmijëve për të mbrojtur mjedisin. Këto lojëra përfshinin punëtori pikturë me elementë të mjedisit, krijimin e parkut imagjinar të fëmijëve dhe përgatitjen e terrariumeve të tyre gjatë mbikëqyrjes së ekipit të KSDW. Përveç organizimit të lojërave zbatimëse për fëmijët, KSDW promovoi edhe biznese vendore me përgjegjësi korporative, përkatësisht çanta të ripërdorshme nga Arlinda Murtezi, Mia Bags Handcrafted, Kompostopia & Botanica LLC. Një pjesë e rëndësishme e kësaj dite ishin fjalimet që individët me ndikim në sferën e zhvillimit të qëndrueshëm mbajtën para audiences. Krahas këtyre aktiviteteve, në mesditë, filloi xhiroja me biçikleta nga vendndodhja e njejtë në Sheshin Zahir Pajaziti.



Për të përmbyllur shënimin e Ditës Botërore të Mjedisit, INDEP në partneritet me Komunën e Prishtinës dhe Marakli t'Biciklave organizuan 'Kinemanë me biçikleta'. Në mbrëmjen e 5 qershorit, më shumë se 50 njerëz u mbledhën për të parë filmin "Bikes vs. Cars", i cili trajtoi përfitimet e çiklizmit dhe dëmet që sjellin në mjedisin e mjedisit.





# “Forumi Politik i Agjendës 2030 dhe OZhQ-ve”

INDEP-i ka organizuar për herë të parë në Kosovë “Forum Politik të Agjendës 2030 dhe OZhQ-ve” përgjatë 24 dhe 25 Nëntorit me 3 Panele Diskutimi dhe 2 Grupe Punuese me të ftuar nga institucionet qendrore dhe lokale, shoqëria civile, sektori privat dhe akademja. Ky Forum ka pasur për qëllim inkurajimin dhe promovimin e dialogut ndërmjet këtyre akterëve për të identifikuar sfidat sistematike me të cilat përballlet Agjenda 2030, krijimin e dialogueve ndër-sektoriale, duke përfshirë kështu të gjithë akterët relevantë në avancimin e Agjendës 2030, dhe vënien në pah të rëndësisë së përfshirjes së barabartë të cdo individi në këto procese. Forumi Politik nisi me Ngjarjen Hapëse, e cila u mbajt me 24 Nëntor me folës të nivelit më të lartë, përfaqësuar nga z. Getoar Mjeku, Zv. Ministër i Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, znj. Fatmire Kollçaku Mullhaxha, Kryesuese e Këshillit për Zhvillim të Qëndrueshëm në Kuvendin e Republikës së Kosovës, znj. Maria Suokko, Koordinatore e Përkohshme e KB për Zhvillim, z. David Oberhuber, Drejtor i GIZ Kosovo dhe Maqedonisë së Veriut, z. Joachim Roth, Zyrtar i BE-së në Rrjetin e Asociacioneve të Autoriteteve Lokale të Evropës Juglindore (NALAS), z. Sazan Ibrahim, Drejtor Ekzekutiv i AKK-së, si dhe z. Burim Ejupi, Drejtor Ekzekutiv i INDEP-it, të cilët përshëndetën iniciativën dhe shprehën mbështetjen e institucioneve të tyre për avancimin e Agjendës 2030 dhe OZhQ-ve në vend.

Dita e parë vazhdoi me 2 panele diskutimi dhe 2 Grupe Punuese. Paneli i parë i diskutimit u zhvillua për temën “Hartëzimi social për një Qasje Gjithëpërfshirëse– kornizë udhëzuese për hartimin e politikave të bazuara në të dhëna në nivel komunal”. Paneli i dytë diskutuese pati për temë “Një perspektivë e përgjithshme mbi sfidat e mbledhjes së të dhënave në nivel kombëtar në Kosovë: Si ndikon mungesa e të dhënave cilësore në zbatimin e duhur të Agjendës 2030”. Ndërsa, grupi i parë punues pati përfaqësues të niveli lokal i qeverisjes, kurse grupi i dytë punues ka pasur përbërje nga niveli qendror i qeverisjes me sektori privat. Pjesëtarët nga sektori i shoqërisë civile u shpërndanë në të dy grupet punuese. Diskutimet trajtuan avancimin e Agjendës 2030 dhe OZhQ-ve



Dita 2, 25 Nëntor, filloi me një session ligjërues nga znj. Ana Jovanovska, Ish-koordinatore e Procesit të Përpilimit të Raportit Vullnetar Kombëtar (VNR) në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Znj. Jovanovska përmbledhi në një sesion një-orësh sfidat e Procesit të VNR-së dhe mundësitë që ky raport na ofron. Dita 2 u përmbyll me një Panel Diskutimi me temën “Partneritetet dhe bashkëpunimet ndërsektoriale për zhvillim të qëndrueshëm: Roli i sektorit privat sa i përket “rritjes së gjelbër”.

Në fund të Forumit u lëshuan Deklaratat e Përbashkëta, të cilat janë përpiluar me qëllim të koordinimit dhe avancimit të hartëzimit social dhe Agjendës 2030 në mes të institucioneve relevante. Ky forum do të shërbejë për përpilimin e një raporti me rekomandime dhe të dhëna nga panelet diskutuese dhe grupet punuese, të cilat do t'i dorëzohen Këshillit për Zhvillim të Qëndrueshëm dhe institucioneve relevante në mënyrë që të fillohet Procesi i Përpilimit të Raportit Vullnetar Kombëtar nga Kosova.

# INDEP kontribuon në raportin mbi Samitin e Sistemeve Ushqimore 2021 të Organizatës së Kombeve të Bashkuara (OKB)

Në kuadër të programit të zhvillimit të qëndrueshëm, INDEP ka një kohë që po avokon për transformim të sistemit ushqimor të Kosovës në një sistem të qëndrueshëm, me prodhim dhe konsum të balancuar dhe ndotje më të ulët nga mbetjet ushqimore. Si pjesë e kësaj, INDEP në korrik 2021 mbajti për herë të parë në Kosovë dialogun e pavarur për sistemin ushqimor në Kosovë, të gjeturat e së cilit dialog tashmë janë pjesë e raportit të OKB të publikuar ditë më parë.



## INDEP dorëzon raportin e parë të Kosovës për Samitin e Sistemeve Ushqimore

### OFFICIAL FEEDBACK FORM



Instituti për Politika Zhvillimore (INDEP), në bashkëpunim me Ekipin e Kosovës të Kombeve të Bashkuara dhe Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, javën e kaluar ka organizuar për herë të parë në Kosovë dialogun e pavarur në kuadër të Samitit të Sistemeve Ushqimore 2021. Në dialogun e mbajtur morrën pjesë akterë të shumtë të fushës, të cilët kanë kontribuar përmes komenteve, sygjërimeve dhe rekomandimeve konkrete se si të transformohet sistemi ushqimor në vend në një sistem të qëndrueshëm dhe të përballueshëm për të gjithë.

DIALOGUE DATE	Tuesday, 13 July 2021 10:00 GMT +02:00
DIALOGUE TITLE	Transforming Kosovo's food system: Opportunities to boost sustainable food production and consumption to build back better from COVID-19
CONVENED BY	Institute for Development Policy (INDEP)
DIALOGUE EVENT PAGE	<a href="https://summitdialogues.org/dialogue/31394/">https://summitdialogues.org/dialogue/31394/</a>
DIALOGUE TYPE	Independent
GEOGRAPHICAL FOCUS	Non-UN Member State

The outcomes from a Food Systems Summit Dialogue will be of use in developing the pathway to sustainable food systems within the locality in which they take place. They will be a valuable contribution to the national pathways and also of interest to the different workstreams preparing for the Summit: the Action Tracks, Scientific Groups and Champions as well as for other Dialogues.

Si rezultat i këtij dialogu, INDEP me 13 orrik ka dorëzuar raportin e parë të Kosovës në platformën ndërkombëtare të Samitit të Sistemeve Ushqimore. Ky raport i dialogut bën që për herë të parë zëri i Kosovës dhe rekomandimet e prodhuesve dhe konsumatorëve vendor të dërgohen dhe të jenë pjesë e Samitit të Sistemeve Ushqimore të Kombeve të Bashkuara, i cili u mbajt në vjeshtë të vitit 2021.



# Puna për avancimin e OZhQ-ve

Në kuadër të programit të zhvillimit të qëndrueshëm, INDEP ka mbajtur vazhdimisht takime me hisedarë e politikëbërës për avancimin e agjendës për zhvillim të qëndrueshëm.

Në nivel lokal, INDEP është takuar me kryetarë e zyrtarë të komunave si Istog, Kamenicë, Drenas, Ranilluge, Shtime etj. Me këto komuna kemi arritur të nënshkruajmë marrëveshje bashkë me entitete të ndryshme ekonomike lokale për vendosjen e vend-parkingjeve të koordinuara me planin e mobilitetit komunal për nevojat e komunitetit të çiklistëve.

Objektivi kryesor i projektit është të përmirësojë kushtet për zbatimin e Agjendës 2030 dhe raportimin në Ballkanin Perëndimor përmes shkëmbimit të eksperiencave, rrjetëzimit dhe mësimit rajonal.



INDEP ka mbajtur takime, ka organizuar punëtori dhe tryeza me më shumë se 700 pjesëmarrës në total në këto aktivitete. Këto aktivitete janë realizuar me qëllim që të mbështeten organet koordinuese të OZhQ-ve në Kosovë dhe të krijohen kushtet për Raportimin Vullnetar Kombëtar të OZhQ-ve, duke siguruar raporte analitike që përmbledhin rezultatet nga grupet tematike që përfshijnë edhe organizata të tjera nga sektori i shoqërisë civile, si dhe biznese nga sektori privat.

Gjithashtu, INDEP mbështet edhe punën e Këshillit për Zhvillim të Qëndrueshëm brenda Kuvendit të Kosovës dhe është partner i këtij Këshilli.



INDEP që nga viti 2019, në bashkëpunim me Asociacionin e Komunave të Kosovës (AKK) ka filluar zbatimin e projekteve rajonale me fokus në ngritjen e kapaciteteve të komunave në aplikimin e hartës sociale “Qasja Gjithëpërfshirëse” dhe në procesin e Lokalizimit të OZhQ-ve. Ky bashkëpunim rajonal është bërë me qëllim që të bëhet shkëmbimi rajonal të praktikave të mira dhe zhvillimi i kapaciteteve të akterëve përkatës publik dhe të tjerë në fushën e të drejtave sociale dhe të njeriut dhe përfshirjen e grupeve vullnetare, duke synuar përmes këtyre përbushjes së Objektivëve të Zhvillimit të Qëndrueshëm dhe avancimin e Agjendës 2030. synon të përmirësojë kushtet për zbatimin e Agjendës 2030 dhe raportimin në Ballkanin Perëndimor përmes shkëmbimit rajonal, rrjetëzimit dhe mësimin (me fokus në Maqedoninë e Veriut dhe Kosovën). Të dy projektet ndajnë aktivitete që përipiqen të kontribuojnë në zhvillimin e kapaciteteve të organeve koordinuese të OZhQ-ve në nivel qendror si dhe në mbështetjen e komunave në zhvillimin e kapaciteteve për lokalizimin e OZhQ-ve. Projektet mbështeten nga Ministria Federale Gjermane për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (BMZ), Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) si dhe bashkëpunojnë edhe me Rrjetin e Asociacioneve të Autoriteteve Lokale në Evropën Juglindore (NALAS) si partner i tyre i përbashkët politik.

Gjithashtu, INDEP ka implementuar fushatën vetëdijësuese në lidhje me rëndësinë e integritit të OZhQ-ve dhe instrumenteve matëse në nivelin komunal në fillim-vitin e 2021-ës. Disa nga materialet janë të listuaramë poshtë. Kjo fushatë e INDEP është realizuar si pjesë e projektit të financuar nga GIZ nëpërmjet Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë.

## PROCESI I HARTIMIT DHE ZBATIMIT TË POLITIKAVE TË QËNDRUESHME

### Si t'i bëjmë investimet kapitale dhe ofrimet e shërbimeve në përputhje me OZhQ-të?

#### HAPI 01

Formoni grupin punues dhe konsultohuni me zyrtar të trajnuar për OZhQ-të për të shqyrtuar nivelin e kontributit potencial për arritjen e OZhQ-ve

#### HAPI 02

Identifikoni dhe zgjedhni projektet pasi të keni shqyrtuar kontributin e tyre drejt përbushjes së OZhQ-ve dhe të keni kompletuar listën e treguesve të tyre

#### HAPI 03

Analizoni situatën dhe dizajnoni konceptin në detaje duke vlerësuar vlerat bazë të OZhQ-ve dhe kontributin potencial të projektit

#### HAPI 04

Hapni procedurën e tenderimit dhe implementoni projektin duke u siguruar që kriterete e qëndrueshmërisë të arrihen

#### HAPI 05

Përpiloni vlerësimin e ndikimit dhe raportoni mbi investimin e bërë ose ofrimin e shërbimit

## HAPAT

Si të vlerësohet se politikat kanë arritur qëllimet e caktuara dhe kanë sjell ndryshimin?

#### HAPI 01

Formoni grupin punues (përfshini edhe zyrtarin e OZhQ-ve) dhe rishikoni dokumentet strategjike bashkë me investimet kapitale dhe ofrimin e shërbimeve

#### HAPI 02

Mbledhni dhe analizoni të dhënat kuantitative në mënyrë që të llogariten indikatorët e OZhQ-ve në raport me targetet përkatëse

#### HAPI 03

Mbledhni dhe analizoni të dhënat kualitative në mënyrë që të llogariten indikatorët e OZhQ-ve dhe sigurohuni që keni arritur t'i përfshini edhe grupet e rezikuara

#### HAPI 04

Kontrolloni, raportoni dhe adresoni OZhQ-të në dialogun publik





# "INDEP është kampion i OZhQ-ve në Kosovë" -

**Ulrika Richardson, Koorditore për Zhvillim e OKB-së gjatë Dialog të Pavarur mbi Sistemet Ushqimore, 13 Korrik 2021**



# Bashkëpunimi Rajonal

Parafjalë

Për ne

Qeverisja Demokratike

Zhvillimi i Qëndrueshëm

Bashkëpunimi Rajonal

LISTA E PUBLIKIMEVE

LISTA E REAGIMEVE

Përmes programit të bashkëpunimit rajonal, INDEP-i i rritet aktivitetet në nivel rajonal. Duke qenë se viti 2021 ka qenë pjesërisht i mbyllur për shkak të pandemisë COVID-19, stafi i INDEP-it i ka kufizuar pjesëmarrjet e veta fizike në organizime rajonale, por megjithatë ka marrë pjesë në shumë konferenca, tryeza e trajnime virtuale. Poshtë janë listuar disa nga pjesëmarrjet rajonale të INDEP gjatë 2021-ës.

## INDEP bashkëorganizon seminarin rajonal “Të rinj aktiv për shoqëri prosperuese”

INDEP, bashkë me Shkollën Bullgare të Politikës “Dimitry Panitza”, Universitetin Mesdhetar të Shqipërisë dhe Qendrën për Hulumtim Strategjik dhe Dokumentim në Maqedoni të Veriut kanë bashkëorganizuar seminarin rajonal me titull “Të rinj aktiv për shoqëri prosperuese” nga 5 deri 8 korrik 2021 në Sofje të Bullgarisë. Me pjesëmarrje të rreth 40 të rinjëve të përzgjedhur nga Shqipëria, Kosova, Maqedonia e Veriut, seminari ka shërbyer si shkëmbim i njohurive, përvojave dhe ndërtim të bashkëpunimit rajonal mes të të rinjëve.

Nën udhëheqjen e Dardan Abazit, Udhëheqës i Hulumtimit dhe Menaxher i Programit në INDEP, ekipi nga Kosova mori pjesë aktive në diskutimet mbi politikat mjedisore, Agjendën e Gjelbër, rimëkëmbjen nga pandemia, lidërshtipin, avokimin etj., si dhe rolin që rinia ka në avancimin e një zhvillimi të qëndrueshëm. Pjesëmarrja e INDEP në këtë aktivitet u realizua në kuadër të programit të INDEP për zhvillim të qëndrueshëm.



# INDEP pjesë e rrjeteve ndërkombëtare për energji SE3T.net dhe INETTT

Në kuadër të programit për zhvillim të qëndrueshëm, INDEP promovon zhvillimin ekonomik që avancojnë kauzat sociale dhe politike duke ruajtur mjedisin. Por, puna e INDEP zhvillohet edhe përtej kufinjve të vendit tone, duke ndërlidhur Zhvillimin e Qëndrueshëm me Bashkëpunimin Rajonal. Si urë e programeve, jemi pjesë edhe e rrjeteve ndërkombëtare për energji.

INDEP është pjesë e Rrjetit të Tranzicionit të Energjisë në Evropën Juglindore (SE3T.net). Ky rrjet është nën hijen e revolucionit të kostonë në teknologjitë e energjisë me emitime karboni të ulëta si energjia e erës, panelet diellore dhe mundësisë që sistemet e energjisë të dekarbonizohen. Ky rrjet synon që sistemet tona të energjisë të bazohen në burime të energjisë të sigurta, të pastra dhe me kosto të ulët.

SE3T.net është rrjet rajonal i instituteve të pavarura të tranzicionit të energjisë, me fokus në Evropën Juglindore. Misioni i rrjetit është të kontribuojmë në zgjerimin e potencialit ekonomik dhe instrumenteve për kalim në një të ardhme të qëndrueshme energjetike. Rrjeti ndërton bazën e provave dhe ofron mendime rreth zgjedhjeve më të mira si të kalojmë në fazën tjetër.

Qëllimi i partnerëve të SE3T.net është të nxisë dhe mbështesë bashkëpunimin rajonal në Evropën Juglindore në këtë fushë, si dhe të inkurajojë dialog me akterët kryesorë nga sektori publik, industrisë, akademisë dhe shoqërisë civile. Prandaj, ky bashkëpunim rajonal ka sjellur sinergji dhe krijuar mundësi të përbashkëta mësimore për të lehtësuar tranzicionin e energjisë. Në vitin 2021, është themeluar edhe rrjeti INETTT, pjesë e së cilit është edhe INDEP. Puna e këtij rrjeti do të jetë më e gjerë dhe ka anëtarë nga të gjitha kontinentet. Nga Kosova, INDEP është anëtar i vetëm i rrjetit.



**SE3T.NET**  
thinking future energy systems



# INDEP pjesë e “Koalicionit 27” për klimë, energji dhe mjedis

Instituti për Politika Zhvillimore (INDEP), Grupi për Studime Politike dhe Juridike (GLPS), CNVP Foundation, Sustainability Leadership Kosova (SLK), Qytetarët Aktivë dhe WWF Adria kanë themeluar më 8 tetor 2021 për herë të parë në Kosovë grupin “Koalicioni 27”, për të punuar së bashku rreth klimës, energjisë dhe mjedis. Ky koalicion do të punojë për përmbushjen e standardeve të kërkuara nga Bashkimi Evropian, përmes marrëveshjes së Stabilizim Asociimit. Fokus i bashkimit të këtyre organizatave është avokimi i problemeve të mjedisit dhe kontributi në raportim të drejtë mbi gjendjen aktuale. Kosova, sikur se edhe vendet tjera të Ballkanit Perëndimor të cilat synojnë të bëhen anëtare të BE-së, është e obliguar t'i përmbushë standardet e kërkuara nga Komisioni Evropian. Përmes marrëveshjes së Stabilizim Asociimit, do të angazhohet në zbatimin e të gjitha reformave që do ta përafrojnë Kosovën në mënyrë progresive me BE-në në të gjitha fushat e politikave, deri në përmbushjen e të gjitha standardeve të BE-së. Koalicioni është emëruar 27 sipas Kapitullit 27 i cili ka në fokus mjedisin dhe ndryshimet klimatike, si një nga kapitujt/standardet që duhet të plotësohen dhe mbulon politikat mjedisore të BE-së të cilat kanë për qëllim të promovojnë zhvillimin e qëndrueshëm dhe mbrojtjen e mjedisit për brezat e tanishëm dhe të ardhshëm. Zbatimi i këtyre standardeve kërkon angazhim të përkushtuar të institucioneve qendrore dhe lokale, organizatave të shoqërisë civile dhe akterëve tjerë.



## Koalicionet rajonale për Kapitullin 27 mbajtën një takim të përbashkët në Beograd

Koalicioni 27 i sapoformuar në Kosovë ka filluar aktivitetet e saj, kështu duke u takuar nga afër me koalicionet e ngjashme rajonale në Beograd. Takimi u organizua nga WWF Adria dhe ka ofruar një mundësi njihje dhe bashkëpunimi në aspektin e përafritimit të kapitulli 27 me acquis të BE-së. Gjithashtu, takimi synon që të njoh palët pjesëmarrëse në arritjet e shteteve të Ballkanit Perëndimor në këtë drejtim. Përfaqësuesit e Koalicionit 27 të Kosovës, Liron Gjocaj nga INDEP, Flutra Zymi nga #qytetaretaktive dhe Egzon Tahirukaj nga CNVP Foundation, kanë folur rreth problemeve evidente në Kosovë me mjedisin, ujërat, cilësinë e ajrit, menaxhimit të mbeturinave dhe legjislacionit në fuqi. Për më tepër, në këtë takim u diskutua mbi bashkëpunimin potencial të këtyre koalicioneve si një rrjet regional duke konkretizuar misionin, dhe objektivat që ky rrjetëzim rajonal mund t'ju ofrojë koalicioneve.





# INDEP pjesë e "Programit të Leadershipit Progresiv 2021"

INDEP ka marrë pjesë në programin e organizuar nga Friedrich-Ebert-Stiftung Beograd "Programi i Leadershipit Progresiv 2021", kushtuar përfaqësuesve të organizatave rinore të partive politike progresive dhe aktivistëve të shoqërisë civile nga tetë vendet e rajonit: Serbia, Mali i Zi, Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Kosova, Maqedonia e Veriut, Sllovenia dhe Kroacia. Programi fillimisht u mbajt në Beograd për të vazhduar më pastaj me Tiranë më 22 deri 25 Tetor. Donikë Beqiri, Asistente Hulumtuese në INDEP mori pjesë në këtë program ku u diskutua qasja e BE-së ndaj vendeve të Ballkanit Perëndimor, zhvillimet demokratike në vendet e Ballkanit Perëndimor në kohën



e pandemisë, si dhe përgjithësisht për dinamikën e jashtme dhe të Brendshme të BE-së.

## Koalicioneve rajonale për kapitullin 27 po mbajnë një takim të përbashkët në Beograd



Koalicioni 27 i sapoformuar në Kosovë ka filluar aktivitetet e saj, kështu duke u takuar nga afër me koalicioneve të ngjashme rajonale në Beograd. Takimi u organizua nga WWF Adria dhe ka ofruar një mundësi njohje dhe bashkëpunimi në aspektin e përafrimit të kapitulli 27 me acquis të BE-së. Gjithashtu, takimi synon që të njoh palët pjesëmarrëse në arritjet e shteteve të Ballkanit Perëndimor në këtë drejtim. Përfaqësuesit e Koalicionit 27 të Kosovës, Liron Gjocaj nga INDEP, Flutra Zymi nga #qytetaretaktive dhe Egzon Tahirukaj nga CNVP Foundation, kanë folur rreth problemeve evidente në Kosovë me mjedisin, ujërat, cilësinë e ajrit, menaxhimin e mbeturinave dhe legjislacionin në fuqi. Për më tepër, në këtë takim u diskutua mbi bashkëpunimin potencial të këtyre koalicioneve si një rrjet rajonal duke konkretizuar misionin, dhe objektivat që ky rrjetëzim rajonal mund t'ju ofrojë koalicioneve.

# Lista e Publikimeve

Parafjalë

Për ne

Qeverisja Demokratike

Zhvillimi i Qëndrueshëm

Bashkëpunimi Rajonal

LISTA E PUBLIKIMEVE

LISTA E REAGIMEVE

## 1. Zgjedhjet Parlamentare të Vitit 2021: Programet e Partive Politike dhe Agjenda e Gjellbër (Shkurt, 2021);

Ky punim gjen se programet e partive politike për zgjedhjet e 14 shkurtit janë ndër programet më të dobëta të cilësdo palë zgjedhje që janë mbajtur në Kosovë sa i takon fushës së zhvillimit të qëndrueshëm dhe agjendës së gjellbër.

Asnjë nga programet e partive politike nuk përmban as për së afërmi agjendën e gjellbër dhe konditat kryesore që kjo agjendë përmban. Partitë politike kanë dështuar që të parashohin masa konkrete për të realizuar Agjendën e Gjellbër dhe për të siguruar një tranzicion të mirëfilltë energjetik dhe një Kosovë larg karbonit. Madje, shumica e partive nuk ofrojnë masa konkrete as për ndotjen e ajrit që është ndër shqetësimet kryesore të qytetarëve.



## Rimëkëmbja është e Gjellbër: Përfitimi nga Eficiencia e Energjisë për Sektorin Privat

Analizë Politikash

03/2021



## 2. Rimëkëmbja është e Gjellbër: Përfitimi nga Eficiencia e Energjisë për Sektorin Privat (Mars, 2021);

Ky punim propozon një skemë propozimi për miratim nga Qeveria e Kosovës, Institucionet Ndërkombëtare Financiare dhe KEEF në një përpjekje për

të rritur ekonominë në një periudhë afatshkurtër dhe afatmesme, duke dhënë një impakt të madh në mjedis dhe shoqëri me implikime në gjenerata. Punimi siguron një pasqyrë të mbështetjes qeveritare të sektorit deri më tani dhe përshkruan pikat e mundshme të ndërhyrjes në EE-së, si dhe rekomandimet për funksionalizimin e një skeme të tillë si pjesë e çfarëdo programi të rimëkëmbjes ekonomike që do të ndërmerret gjatë vitit 2021.






### 3. Rimëkëmbja ekonomike dhe ndërtimi i bashkëpunimit ndërinstitucional (Mars, 2021);

Punimi gjen se ka pasur një mungesë të komunikimit të duhur ndërinstitucional për zbatimin e pakos, në veçanti në fushën e mbledhjes së statistikave. Institucionet e Kosovës, veçanërisht institucionet e thirrura për të dhëna statistikore si Agjencia e Statistikave të Kosovës dhe Banka Qendrore e Kosovës nuk janë duke mbledhur të dhëna në baza të rregullta mbi zbatimin e Pakos së Rimëkëmbjes. Për më tepër, nuk ka një kornizë të qartë të indikatorëve që do të ishin specifik vetëm për pakon e rimëkëmbjes dhe që do të ndikonin në rritjen e informimit në baza periodike për progresin në zbatimin e Ligjit.

## Rimëkëmbja ekonomike dhe ndërtimi i bashkëpunimit ndërinstitucional

Analizë e Politikave

3/2021



### 4. Vizualizimi i të dhënave të OZHQ-ve dhe raportimi për komunat e Kosovës (Mars, 2021);

Ky dokument gjeti se komunat nuk kanë të lokalizuar OZHQ-të dhe si pasojë nuk i kanë të fiksuara ose pasqyruara ato në politikat e tyre. OZHQ-të duhet të jenë pjesë përbërëse e dokumenteve kryesore komunale duke filluar nga deklaratat e misionit, te strategjitë dhe planet e veprimit. Siç është evidentuar, procesi i përfshirjes së OZHQ-ve në dokumentet lokale duhet të planifikohet dhe ekzekutohet me kujdes për të marrë parasysh përparësitë komunale, preferencat dhe pritjet e qytetarëve të përshtatura me OZHQ-të përkatëse. Politikat dhe grantet komunale nuk janë të lidhura me zbatimin dhe përmbushjen e OZHQ-ve. Kjo mund të arrihet dhe zbatohet lehtësisht me rregullime të vogla në procesin e politikbërjes komunale.

### 5. Qytete të qëndrueshme të rimenduarit e urbanizimit në Kosovë (Mars, 2021);

Punimi nxjerr si rekomandim të përgjithshëm që konceptet e qëndrueshme duhet të integrohen në shkallën e qytetit, në shkallën komunale dhe në lagje, varësisht nga konteksti lokal dhe potenciali i arritshmërisë. Sidoqoftë, konceptet nuk duhet të shpërndahen ose të implementohen veçmas, pasi ato nuk sjellin ndikim të rëndësishëm për një strategji të zhvillimit të qëndrueshëm.

Punimi në fjalë identifikon termat e OZHQ 11 dhe qëndrueshmërisë urbane, problemet kryesore me të cilat qytetet e Kosovës ballafaqohen, dhe në fund rekomandon masat dhe politikat që duhen zbatuar për të transformuar qytetet e Kosovës në zona të qëndrueshme.





## 6. LOKAL2030 LOKALIZIMI I OZHQ-VE NË KOMUNAT E KOSOVËS (Mars, 2021);

“Lokal2030: Lokalizimi i OZhQ-ve në komunat e Kosovës” përbën një pako që synon të mbështesë administratën lokale në procesin e integritit të OZhQ-ve në zhvillimin dhe implementimin e politikave, duke siguruar udhëzime konkrete për mekanizmat institucional që duhet të krijohen për të siguruar angazhimin politik dhe gatishmërinë teknike, për lokalizimin e Agjendës 2030 për Zhvillim të Qëndrueshëm, mjete dhe udhëzime për secilin hap të zhvillimit dhe zbatimit të politikave, dhe rëndësinë e OZhQ-ve karshi politikave lokale. Grupi kryesor i synuar përmes këtij udhëzuesi është administrata komunale. Sidoqoftë, ky udhëzues mund të jetë i dobishëm për palët e tjera të interesit për të përmirësuar të kuptuarit e tyre kryesisht për rolin e tyre të mundshëm në zhvillimin e politikave lokale dhe proceset e zbatimit, se si këto procese mund të organizohen dhe si të orientojnë përpjekjet e tyre drejt zhvillimit të qëndrueshëm.

## 7. Rimëkëmbja është e gjelbër – Sfidat dhe mundësitë për energjinë e ripërtrishme (Prill, 2021);

Nevojitet një paketë e rishikuar / zgjeruar e rimëkëmbjes së gjelbër e drejtuar nga burimet e ripërtëritshme e cila mund të trajtojë sfida të tjera për Kosovën si ndotja e ajrit, ndryshimi i klimës dhe përmbushja e objektivave të detyrueshme të BRE-ve duke frenuar emetimet e gazeve serë, duke ulur kështu preksshmërinë ndaj sëmundjeve të rrezikshme për jetën. Ky plan i gjelbër i rimëkëmbjes duhet të përputhet me objektivat afatgjatë kombëtare dhe globale mbi qëndrueshmërinë e energjisë dhe zhvillimin e qëndrueshëm. Sa më herët të rritet promovimi dhe investimet për BRE (diellore dhe erë), aq më shumë investime mund dhe duhet të bëhen për inkurajimin e kompanive lokale të BRE-ve dhe prodhuesit e teknologjisë.



## Rimëkëmbja është e gjelbër – Sfidat dhe mundësitë për energjinë e ripërtrishme

Analizë politikash

04/2021



## Pranvera e rimëkëmbjes – niveli i zbatimit, sfidat dhe mundësitë

Analizë Politikash

05/2021



## 8. Pranvera e rimëkëmbjes – niveli i zbatimit, sfidat dhe mundësitë (Maj, 2021);

Masat e përfshira në pako të rimëkëmbjeve ekonomike, e sidomos masat e përfshira në Pakon e Rimëkëmbjes, jo të gjitha kanë gjetur zbatim. Këto masa, në shumë raste nuk përfshirë në agjendën e hisedarëve të Kosovës, e le më që të fillojnë zbatimin e tyre. Madje, për disa nga këto masa, nuk janë përfshirë as në buxhetin e miratuar për vitin 2021.

## 9. Dimensioni Demografik i Agjendës 2030 - Perspektivat dhe Sfidat e Kosovës (Korrik, 2021);

Pyetja themelore në të cilën është orientuar kjo analizë socio-demografike është: si ndikon situata dhe zhvillimet demografike në zhvillimin e qëndrueshëm, cilat janë implikimi e disa nga strukturat më të rëndësishme të popullsisë në zhvillimin e qëndrueshëm? Do të bëhen përpjekje në përgjigje në pyetje a mundë të ketë zhvillim të qëndrueshëm dhe arritje të Objektivave të Agjendës 2030 me paqëndrueshmëri demografike? Të gjitha këto janë analizuar me rastin e Kosovës.



## 10. Pasqyrë e zbatimit të Ligjit për Rimëkëmbjen Ekonomike dhe mësimet e nxjerra (Korrik, 2021);

Punimi përfundon se çfarëdo pako e re e rimëkëmbjes duhet të paraprihet me diskutime të gjera shoqërore dhe ndër-sektoriale. Përzgjedhja e sektorëve për intervenim duhet të bëhet bazuar në një set të kriterëve që marrin parasysh nivelin e afektimit nga pandemia Covid-19, nivelin e ndryshimeve të gjelbra që paraqesin këto ndryshime etj. Për dallim nga ky Ligj dhe pakot që kanë rrjedhur nga ky Ligj, çfarëdo pako tjetër duhet të përmbaj objektiva të matshme, mekanizma të monitorimit të progresit dhe raportimit të rezultateve në mënyrë që të matet impakti në ekonomi.



## 11. Roli i energjisë së ripërtëritshme në arritjen e objektivave për 2030 (Tetor, 2021);

Energjia e ripërtëritshme është vendimtare për të garantuar zhvillim të qëndrueshëm dhe transformim thelbësor të energjisë në Tokë nga energjia e varur prej karburanteve fosile në atë të gjelbër, të përbalueshme dhe rrethore. Energjia e ripërtëritshme, deri tani, është e vetmja formë alternative kundër energjisë prej burimeve ndotëse, e cila jo vetëm që është e qëndrueshme por gjithashtu shmang dëmet mjedisore dhe shëndetësore. Energjia e ripërtëritshme është shndërruar nga një ideal dhe vizion për të ardhmen, në një kërkesë të ngutshme drejt tryezave të politikëbërësve.





## Bashkimi Energjetik Kosovë-Shqipëri - Sfidat dhe Mundësitë për të Ardhmen

ANALIZË E POLITIKAVE

09/2021



### 13. Sistemi ushqimor i Kosovës: Qëndrueshmëria e tij dhe politikat që mungojnë (Nëntor, 2021);

Sistemi ushqimor përballet me shumë pengesa, si mungesa e monitorimit të prodhimit të ushqimit, artikuj ushqimor të përpunuar së tepërmi që nuk promovojnë ndonjë dietë të shëndetshme dhe ushqyese, menaxhim i dobët i mbeturinave ushqimore për të përmendur disa prej tyre. Kjo shkakton probleme në 3 dimensione, në atë social, ekonomik dhe mjedisor. Prodhimi dhe konsumi i qëndrueshëm i ushqimit, krahas zhvillimit të viseve rurale dhe fermerëve, parashihen edhe në marrëveshjet dhe deklaratat rajonale për Ballkanin Perëndimor, ku përfshihet edhe Kosova.

Studim politikash: →

### RINGJALLJA PËRMES KREDIVE – PRITJET DHE ARRITJET E MASËS SË DYTË TË PAKOS SË RINGJALLJES



### 12. Bashkimi energjetik Kosovë-Shqipëri – Sfidat dhe mundësitë për të ardhmen (Nëntor, 2021);

Bashkimi energjetik Kosovë-Shqipëri është politikë që jo vetëm sjell përfitime socio-ekonomike, por edhe afron të dy vendet në rrugën e integritimit evropian. Marrë shembull praktikat e mëhershme të shteteve anëtare të BE-së, është e dëshmuar se tregjet e tilla të përbashkëta kanë benefite shumë më të mëdha në krahasim me tregjet vetanake. Benefitet që sjell operimi energjetik përmes tregut të përbashkët mundësojnë zhvillimin e mëtutjeshëm energjetik dhe ekonomik të vendeve pjesëmarrëse. Bashkimi i tregjeve të energjisë ofron potencial shumë të mirë edhe për sigurimin e furnizimit me energji, por edhe për uljen e nevojës për prodhim të energjisë. Për më tepër, duke u rritur efikasiteti i përgjigjes kërkesë-ofertë ulet edhe nevoja për kapacitete të prodhimit, ngase sasia e kapacitetit rezervë që nevojitet të prodhohet ulet.

### Sistemi ushqimor i Kosovës: Qëndrueshmëria e tij dhe politikat që mungojnë



### 14. Ringjallja përmes kredive – Pritjet dhe Arritjet e masës së dytë të Pakos së Ringjalljes (Nëntor, 2021);

Ndonëse pandemia shkaktoi rënje drastike të bruto-prodhimit vendor dhe aktivitetit ekonomik, pakot e rimëkëmbjes krahas hapjes së ekonomisë kanë treguar efektet e tyre. Përmes pakove të kaluara dhe pakos aktuale, sektorët ekonomik po ndihmohen në mënyrë që të u lehtësohet rimëkëmbja nga dëmet që pandemia COVID-19 ka shkakuar. Edhe pse një gjë e tillë po ndodh me hapa jo shumë të shpejtë, shenjat janë pozitive që përmes lehtësimeve dhe ndihmave, do të tejkalohej vështirësitë e bizneseve dhe performanca e përgjithshme e ekonomisë do t'i kthehet shifrave pozitive.


### 15. Raport i monitorimit i zbatimit të pakos së ringjalljes ekonomike të qeverisë (Dhjetor, 2021);

Ky raport pasqyron të arriturat e deri tashme të Pakos së Ringjalljes Ekonomike. Pandemia COVID-19 ka shkaktuar dëme në thuajse secilën sferë të jetës. Vështirësitë e qytetarëve ndaj një vështirësie të tillë, pa ndihmën e akterëve më të lartë shtetëror, do të përshkallëzoheshin duke rrezikuar seriozisht mirëqenien sociale dhe atë ekonomike. Pasojat e pandemisë u tentua të zbuten përmes pakove të cilat përmbanin masa ndihmuese për kategoritë më të prekura nga kjo sfidë. Në Republikën e Kosovës, gjatë periudhës pandemike u miratuan disa pako të ndihmave. Këtyre pakove ju parapriu Pako Emergjente Fiskale në muajin mars të vitit 2020, e pastaj Pako e Rimëkëmbjes Ekonomike në muajin dhjetor të vitit 2020 dhe së fundmi Pako e Ringjalljes Ekonomike që erdhi në muajin korrik të këtij viti. Përfundimisht, që nga fillimi i pandemisë COVID-19 në Republikën e Kosovës, e deri më sot janë ndarë gjithsej 820.65 milionë Euro. Pako e fundit është më e madhja për nga shuma dhe më voluminozja, prandaj edhe monitorimi i saj paraqet rëndësi më të madhe.

Raport i Monitorimit



# I ZBATIMIT TË PAKOS SË RINGJALLJES EKONOMIKE TË QEVERISË



# Lista e Reagimeve

Parafjalë

Për ne

Qeverisja Demokratike

Zhvillimi i Qëndrueshëm

Bashkëpunimi Rajonal

LISTA E PUBLIKIMEVE

LISTA E REAGIMEVE

1. Reagim në lidhje me akuzat drejtuar Kryesueses së Komisionit të Zgjedhjeve të , znj.

Valdete Daka

2. Subjektet politike po injorojnë të drejtat e konsumatorëve në platformat e tyre për zgjedhjet e 14 shkurtit

3. Kundërshtim ndaj vendimit të Qeverisë për subvencionimin e sigurimit të automjeteve të huaja që hyjnë në Kosovë me përfitues individët privat

4. Organizatat e shoqërisë civile kundërshtojnë shkarkimin e Kryetares së KQZ-së

5. Qeveria të publikoj skenarin alternativ ndaj refuzimit të projektit të gazit

6. Letër publike drejtuar Komisioni i Pavarur i Mediave - KPM lidhur me ankesat e konsumatorëve për manipulime nga ana e operatorëve kabllorë

7. Kërkohet përgjegjësi dhe hetim i thellë për të qartësuar arsyen e helmimit të rreth 840 konsumatorëve në Deçan

8. Kompania Rajonale e Ujësjellësit "Prishtina" Sh.A nuk ka plotësuar kushtet ligjore për të mbajtur diskutimin publik të nesërm mbi çmimin e ujit për zonën e shërbimeve të KRU "Prishtina"

9. Kriza energjetike është në radhë të parë krizë e vendimmarrjes dhe politikave të munguara!

10. Ndaleni terrin për konsumatorët dhe respektoni Ligjin për Mbrojtjen e Konsumatorit!





# Donatorët 2021

INDEP falenderon për zemërsisht të gjithë donatorët që e kanë mbështetur punën tonë gjatë vitit 2021. Pa besimin në vizionin e INDEP për një Kosovë demokratike, funksionale, të integruar në rajon dhe në bashkësinë ndërkombëtare dhe misionin për të fuqizuar dhe promovuar zhvillimin e qëndrueshëm socio-politik dhe ekonomik të bazuar në parimet e demokracisë dhe vlerave demokratike, mundësive të barabarta, drejtësisë sociale dhe mjedisore dhe të drejtave të njeriut kjo punë dhe vit i suksesshëm i INDEP do të ishte i pamundur.



**Funded by  
the European Union**



